



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:005414

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05624393

KPPP.nr. 1583/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania për Transport Ndërkombëtare Eksport-Import “Vijator” d.oo. me seli në Preshëve, të cilin e përfaqëson me autorizim A.B. avokat nga Prishtina, kundër debitorit N.T.SH. “Pandora”, me numër unik identifikues 80414471 dhe seli në Vranidoll, Komuna e Prishtinës, duke vepruar sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 1061/21, i lejuar me datë 09.12.2021, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori me seli të zyrës në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.SH. “Pandora”, me numër unik identifikues 80414471 dhe seli në Vranidoll, Komuna e Prishtinës, ashtu që Urdhri përmbartimor P.nr. 1061/21, i lejuar me datë 09.12.2021, nga Përmbartuesi Privat Driton Govori ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumenteve të besueshme; Faturës nr. 446/016 e datës 10/03/2016; Faturës nr. 505/016, e datës 16.03.2016; Faturës nr. 679/016 e datës 11.04.2016; Faturës nr. 680/016, e datës 11.04.2016; Faturës nr. 956/016, e datës 23.05.2016; Faturës nr. 1537/016 e datës 28.07.2016; Faturës nr. 1553/016 e datës 29.07.2016; Faturës nr. 1561/016 e datës 29.07.2016; Faturës nr. 1562/016 e datës 01.08.2016; Faturës nr. 1586/016 e datës 02.08.2016; Faturës nr. 1844/016 e datës 02.09.2016; Faturës nr. 1846/016 e datës 02.09.2016; Faturës nr. 2077/016 e datës 30.09.2016; Faturës nr. 2081/016 e datës 30.09.2016; Faturës nr. 2411/016 e datës 01.12.2016; Faturës nr. 2939/16 e datës 23.12.2016; Faturës nr. 2778/16 e datës 06.01.2016; Faturës nr. 2584/16 e datës

18.12.2016; Faturës nr. 2942/16 e datës 03.01.2017 Faturës nr. 2008/19 e datës 28.09.2019; Faturës nr. 699/19 e datës 11.04.2019; Faturës nr. 960/17 e datës 10.04.2017; Faturës nr. 1602/17 e datës 12.06.2017; Faturës nr. 1764/17 e datës 21.06.2017; Faturës nr. 3949/17 e datës 22.12.2017; Faturës nr. 4007/17 e datës 25.12.2017; Faturës nr. 066/18 e datës 17.01.2018; Faturës nr. 158/18 e datës 13.02.2018; Faturës nr. 317/18 e datës 27.02.2018; Faturës nr. 1789/18 e datës 11.07.2018; Faturës nr. 1863/18 e datës 03.07.2018; Faturës nr. 1993/18 e datës 16.07.2018; Faturës nr. 2442/18 e datës 08.09.2018, si dhe; Faturës nr. 2506/18 e datës 03.10.2018, ka lejuar Urdhrin Përmbartimor P.nr. 1061/21 të datës 09.12.2021, me të cilin është urdhëruar debitori, që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimet të urdhrit, kreditorit t'ia paguaj shumën prej EUR 58,230.00 me kamatë prej 12% duke llogaritur nga data 10.03.2016 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimor.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin për përmbartim, duke theksuar urdhri përmbartimor nuk paraqet gjendjen reali ngase shumica e pagesave janë kryer dhe se debitori nuk i ka mbetur borxh kreditorit për shërbimet e ofruar. Me tej, ka shtuar se kreditori nuk ka justifikuar se s ka ardhur deri te borxhi ngase sa ka zgjatur bashkëpunimi mes palëve, debitori nuk kishte pranuar asnjëherë ndonjë vërejtje për mos pagesë të borxhit, ndërsa ka theksuar se deklaratimet e njëanshme dhe faturat e paraqitura nga vetëm njëra palë duke faturuar fatura nuk i japin të drejtë dhe nuk ofrojnë mundësi që shkresa të tilla të kualifikohen si bindëse për gjykatën. Në fund, ka theksuar se kërkesa e kreditorit është përfshi në parashkrim në kuptim të neni 353 të LMD-së. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësim, ku prapësimi i debitori është i pa bazuar dhe nuk është i mbështetur në prova në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së. ndërsa, ka theksuar se debitori Vlen të ceket se debitori asnjëherë në prapësim nuk e ka kontestuar se ka pranuar shërbimet nga kreditori, por thekson se vetëm shumica e pagesave janë të kryera, pra më këtë dëshmohet se kemi borxh të pa shlyer. Tutje, pretendimi se faturat e bashkangjitura në urdhrin përmbartimor nuk kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 të LPP-së, nuk qëndron pasi që fatura përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme, pasi që janë evidentuar kreditori, debitori si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Ndërsa, ka kundërshtuar edhe pretendimet për parashkrimin e kërkesës me arsyetim se debitori nuk ka mohuar borxhin asnjëherë ndaj kreditorit mirëpo që vetëm i ka kërkuar që t'i ipet kohë shtesë për shlyerjen e detyrimeve dhe se debitori ka kryer pjesërisht pagesa me datë 19.08.2019.

Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin ta refuzoj në tërësi si të pabazuar ashtu që urdhri përmbarrimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, si dhe vlerësimin të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore, (tutje “LPP”), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarrimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: *“Përmbarrimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarrimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarrim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: *“Kur propozimi për përmbarrim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe të përshtatshme për t’iu nënshtruar procedurës përmbarrimore, ngase në secilën nga faturat e paraqitura në propozim është përcaktuar Gjykata në Leskovac si gjykatë kompetente në rast kontesti, dhe si rrjedhojë e kësaj rezulton se palët kanë përjashtuar mundësinë që të njejtat fatura ti nënshtrohen procedurës përmbarrimore, andaj faturat si të tilla nuk mund të konsiderohet si dokumentet të përshtatshme për përmbarrim në kuptim të nenit 29, pika 1.3 të LPP-së, ndërsa prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nenin 71, pika 1.1 të LPP-së/

Veç të metave si më lartë, gjykata gjen se zbatimi i dokumentit të besueshëm të lëshuar nga një subjekt i vendit të huaj sikurse në rastin konkret, duhet t’i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të nenit 11 të LPP-së, sipas të cilit *“Përmbarrimi i dokumentit të huaj përmbarrimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbarrimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për praninë dhe përmbarrim.”*

Megjithatë, vendosja në këtë çështje përmbarrimore nuk e paragjykon të drejtën e palës kreditore që, lidhur me pretendimet për borxhin sipas faturave, të inicioj proces të rregullt civil pranë gjykatës kompetente.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit në raport me parashkrimin e kërkesës së debitorit që buron nga faturat, mirëpo përderisa gjykata ka vlerësuar se faturat nuk i plotësojnë elementet për të shërbyer si dokumente të përshtatshme për përmbarim, nuk u lëshuar në vlerësimin e pretendimeve tjera të natyrës materiale.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1583/22, datë 26.04.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.